

Partnerët Shqipëri hap thirrjen për aplikime për eventin "RRATHË DHURUES" (GIVING CIRCLE)



#RrathëDhurues
Shqipëri

A keni një ide inovatore që mund të përmirësojë cilësinë e jetës së një komuniteti të caktuar por nuk keni para?
Jeni duke zbatuar një nismë konkrete në komunitet por nuk keni burime të mjaftueshme?

Kjo është mundësia e duhur për ta vënë në praktikë idenë tuaj!

Partnerët Shqipëri hap thirrjen për aplikime për të gjitha OJF-të që kanë një ide konkrete apo nismë në zbatim për të sjellë ndryshim social në një komunitet të caktuar, përmes mbështetjes edhe nga vetë komuniteti. **Tre idetë më të mira** do të përzgjidhen për t'u zbatuar duke fituar mbështetje financiare dhe në natyrë përmes një ankandi live i cili do të organizohet në qershor 2022.

Çfarë është eventin "Rrathë Dhurues"

Rrathë Dhurues (Giving Circle) është një event që zhvillohet në 24 vende të botës, që mbledh së bashku individë të cilët përmes shembullit të tyre personal dhurojnë për kauza sociale duke treguar një ndjenjë të lartë qytetarie dhe solidariteti njerëzor. Këta individë nga fusha të ndryshme vënë në dispozicion ekspertizën, kohën dhe burimet financiare për të mbështetur projekte/kausa konkrete që sjellin ndryshime sociale në komunitete të caktuara. Përmes këtij eventin do të mundësohet mbështetja e tre nismave konkrete komunitare.

Komponentët e procesit:

- Hapja e thirrjes për aplikime për OJF** të cilat kanë një ide inovatore apo nismë në zbatim për të kontribuar apo ndikuar në komunitete të caktuara;
- Sesion informues** me OJF-të e interesuara në datën **13 prill 2022**, ora **10.00**.
Regjistrohuni në këtë link për të marrë pjesë në sesionin informues: <https://bit.ly/3r5jxTe>
- Përzgjedhja e 3 ideve më të mira** të cilat synojnë sjelljen e një ndryshimi në komunitetet e targetuara;
- Trajnimi i përfaqësuesve të ideve fituese** për të realizuar një prezantim të suksesshëm gjatë eventin;
- Prezantimi i idesë në event** - çdo ide do të prezantohet dhe do t'ju përgjigjet pyetjeve të audiencës brenda 12 minutave. Mbështetësi i çdo ideje do të prezantohet qëllimin e mbështetjes dhe do të motivojë audiencën që t'i bashkohet kësaj kauze. Moderatorin e eventin do të ftojë audiencën të dhurojë për secilën nga idetë e përzgjedhura. Dhurimet do të llogariten live. Shuma minimale e synuar për secilën ide është 300,000 lekë.
- Promovimi i ideve të financuara**. Tre idetë e financuara do të promovohen gjerësisht përmes të gjitha kanaleve të komunikimit për të promovuar zbatimin dhe rezultatet e ndërhyrjeve.

Përse duhet të aplikoni

- Mundësi për promovimin e punës / idesë suaj para një audience të gjerë dhe të zgjedhur;
- Mundësi për tërheqjen e mbështetësve të rinj dhe krijimin e partneriteteve të reja;
- Ka gjithmonë e më pak burime financiare në dispozicion për projekte komunitare;
- **Bashkimi bën fuqinë!** Nëse të gjithë mblidhen bashkë dhe dhurojnë pak, impakti është më i madh.

Procesi i Aplikimit

- Thirrja është e hapur për të gjitha OJF-të që kanë një ide inovatore apo nismë në zbatim që ka qëllim përmirësimin e jetës së komuniteteve të caktuara;
- Kandidatët e interesuar janë të ftuar të aplikojnë duke plotësuar **Formën e Aplikimit dhe Deklaratën e Mbështetësit**;
- Afati për dërgimin e aplikimeve është data **29 prill 2022** në adresën: kkeruti@partnersalbania.org

Përzgjedhja

- Tre idetë fituese që do të marrin pjesë në eventin "Rrathë Dhurues" do të përzgjidhen nga një juri profesionistësh, përfaqësues të sektorëve të ndryshëm.
- Ideja/projekti duhet të zgjidhë një nevojë konkrete dhe të ketë impakt të dukshëm në një komunitet apo komunitete të caktuara;
 - Ideja duhet të ketë mbështetjen e komunitetit dhe ta përfshijë atë;
 - Çdo aplikant duhet të sigurojë një mbështetës kryesor si pjesë e procesit të aplikimit, që beson tek iniciativa dhe kontribuon financiarisht apo në natyrë (pavarësisht shumës).
 - Iniciativat fituese duhet të angazohen në sigurimin edhe të mbështetësve të tjerë, që duhet të jenë pjesë e eventin.

Një pasqyrë e eventeve "Rrathë Dhurues" ndër vite

Përgjatë dy eventeve Rrathë Dhurues të organizuara në Shqipëri prej vitit 2018, falë kontributit të individëve, biznesit dhe organizatave të shoqërisë civile, vlera prej 4,920,024 Lekë kontribuoi në mbështetje të gjashtë nismave komunitare në fushën e edukimit, promovimit të të drejtave të njeriut, aktivizimit rinor, sportit dhe kulturës duke sjellë ndryshime të qëndrueshme në komunitetet e targetuara.



Iniciativat e mbështetura përmes Rrathë Dhurues 2021

Këndi i lojrave në Lana Bregas

Një iniciativë e Nismës për Ndryshim Shoqëror ARSIS

Përmes mbështetjes së siguruar u mundësua ndërtimi i një këndi lojrash në Lana Bregas duke kontribuar në krijimin e një mjedisi argëtues për 126 fëmijë të këtij komunitetit. Nisma ka ndikuar gjithashtu në rritjen e ndërgjegjësimit të prindërve dhe komunitetit lokal mbi rëndësinë e qëndrueshmërisë së investimit me kontribut në rritjen e socializimit të fëmijëve përmes aktiviteteve argëtuese.



Klikoni foton për më shumë mbi iniciativën

Qendra Multifunktionale Thumanë

Një iniciativë e organizatës Vizion i Ri

Qendra multifunktionale Thumanë tashmë është një mjedis i kompletuar dhe i përshtatshëm për fëmijët dhe të rinjtë jo vetëm të zonës së Thumanës, por edhe të qyteteve përreth. Falë mbështetjes përmes Rrathë Dhurues, Qendra ka zgjeruar gamën e aktiviteteve për të rinjtë duke kontribuar në rritjen e aktivizimit rinor përmes vullnetarizmit, zhvillimit të lidershit rinor, etj.



Klikoni foton për më shumë mbi iniciativën

Këndi i studimit

Një iniciativë e organizatës Tek Ura

Falë mbështetjes së siguruar përmes Rrathë Dhurues, 14 familje në zonën e Tufinës, të cilat kanë 3 – 5 fëmijë në ciklin 9 vjeçar, u pajisën me një kënd studimi dhe mjetet e duhura shkollore, duke mundësuar kushtet bazë për përgatitjen për lëndët mësimore. Gjithashtu një kënd studimi i përbashkët në ambientet e Tek Ura shërben për 250 fëmijë dhe të rinj të tjerë në nevojë të këtij komuniteti.



Klikoni foton për më shumë mbi iniciativën